



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE \* MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA \* SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 40 të Statutit të Komunës së Prishtinës, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 18.07.2003 merr:

## V E N D I M

**PËR NDRYSHIMN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR FILLIMIN DHE MBARIMIN E ORARIT TË PUNËS NË LËMIN E EKONOMISË, TREGËTISË, HOTELIERISË DHE SHËRBIMEVE TË TJERA NË TERITORIN E KOMUNËS SË PRISHTINËS. 01. nr.330-162 e datës 07.02.2002**

### I

Ndryshohet dhe plotësohet Rregullorja për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës në lëmin e ekonomisë, tregëtisë, hotelierisë dhe shërbimeve të tjera në teritorin e Komunës së Prishtinës. 01. nr.330-162 e datës 07.02.2002 dhe atë:

NENI 7 - ndryshohet dhe thot:

Objektet për shitjen e karburanteve do të punojnë: sipas orarit të vetpërcaktuar dhe të lejuar nga Drejtorati për Ekonomi.

Së paku një pikë shitjeje do të kujdestarohet non-stop 24 orë. Orarin e kujdestarisë do ta përcaktojnë subjektet afariste, të cilat merren me shitjen e karburanteve. Orari do të përpilohet për një muaj dhe do t'i dorëzohet Inspeksionit të Tregut në fund të muajit për muajin vijues.

### IV. DISPOZITAT NDËSHKUESE

NENI 9 - Ndryshohet dhe thot:

Të gjitha subjektet afariste, të cilat nuk e respektojnë orarin e punës, të fillimit dhe mbarimit, të paraqitur në nenet: 4, 5, 6, 7 dhe 8, e i cili do të konstatohet nga Inspeksioni dhe policia, do të denohen për kundërvajtje në shumën prej:

Personi juridik.....300 deri 400 Euro,  
Pronarët e dyqaneve të pavarura.....150 deri 250 Euro,

NENI 10 - Ndryshohet dhe thot:

Të gjitha subjektet afariste, të cilat konstatohet se kanë zgjatur orarin e punës të paraqitur në nenet: 4, 5, 6, 7 dhe 8, pa vendimin e Drejtoratit për Ekonomi, do të gjobiten për kundërvajtje prej

Personat juridik..... 250 deri 350 Euro,  
Pronarët e dyqaneve të pavarura.....150 deri 250 Euro,

### II

Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**

Nr. \_\_\_\_\_ Dt. \_\_\_\_\_

**KRYETARI**  
Ismet Beqiri